

**LIGJI Nr. 04/L-157 PËR AVOKATURËN SHETËRORE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR AVOKATURËN SHETËRORE**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Fushëveprimi**

Me këtë ligj rregullohet themelimi, organizimi dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe të avokatëve shtetëror, mjetet për punë, autorizimet e tyre, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e saj.

**Neni 2  
Themelimi**

Me këtë ligj themelohet Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës (më tej: Avokatura Shtetërore), si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i përfaqësimit të pavarur ligjor të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës në procedurat gjyqësore, të arbitrazhit dhe administrative.

**Neni 3  
Parimet e punës**

1. Avokatura shtetërore kryen funksionin e vet në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e zbatueshme dhe me aktet e përgjithshme nënligjore.
2. Askush nuk ka të drejtë që të ndikojë në çfarëdo mënyre në Avokaturën Shtetërore, në kryerjen e funksionit të saj.

**Neni 4  
Puna publike**

1. Puna e Avokaturës Shtetërore është publike dhe secili person mund të ketë qasje në informacione në pajtim me ligjin.
2. Nëse Avokati i Përgjithshëm Shtetëror konsideron se kjo është e dobishme, mundet nëpërmjet mjeteve të informimit ta informojë publikun për shkallën e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të autoriteteve publike.

**Neni 5  
Gjuhët**

Në punën e Avokaturës Shtetërore në përdorim janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

**Neni 6  
Vula**

1. Avokatura Shtetërore ka vulën e saj sipas formës dhe diametrit të përcaktuar me dispozitat për vulat.
2. Vula e Avokaturës Shtetërore ka formën rrethore, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.
3. Madhësia e vulës së Avokaturës Shtetërore është me diametër dyzet (40) mm.
4. Teksti i vulës së Avokaturës Shtetërore shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës.
5. Vula e Avokaturës Shtetërore përmban këto të dhëna:
  - 5.1. në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës;
  - 5.2. në rrethin e dytë shkruhet: Qeveria e Republikës së Kosovës;
  - 5.3. në rrethin e tretë shkruhet: Ministria e Drejtësisë;
  - 5.4. në rrethin e katërt shkruhet: Avokatura Shtetërore; dhe
  - 5.5. në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit më të vogël të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës.

## **KREU II STATUSI JURIDIK, KOMPETENCA DHE ORGANIZIMI I AVOKATURËS SHETËRORE**

### **Neni 7 Statusi juridik**

1. Avokatura Shtetërore është organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Avokatura Shtetërore ka statusin e personit juridik me seli në Prishtinë.

### **Neni 8 Kompetenca**

1. Avokatura shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin.
2. Avokatura Shtetërore kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Neni 9 Ushtrimi i funksionit**

1. Funksionin e avokaturës shtetërore e ushtrojnë, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror në kryerjen e funksionit të tyre janë të pavarur. Avokati i Përgjithshëm për punën e vet i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror e paraqet dhe përfaqëson Avokaturën Shtetërore, udhëheqë dhe ndërmerr veprime për të cilën është i autorizuar me këtë ligj, apo ligj tjetër.

### **Neni 10 Avokatët shtetëror**

1. Avokatët shtetëror për punën e tyre i përgjigjen Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.
2. Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror ua ndan detyrat avokatëve shtetërorë, dhe iu jep udhëzime të përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Në kuptim të këtij ligji, udhëzimet për punën e avokatëve shtetërorë përfshijnë drejtimit e përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave dhe të aktiviteteve, si dhe orientimet për ndërmarrjen e procedurave dhe të masave në rastet konkrete.
4. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokatura Shtetërore është e autorizuar që të ndërmarr të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.
5. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror mund të autorizojë edhe personin e punësuar në Avokaturën Shtetërore me provim të dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punët juridike që të përfaqësoj në gjykata dhe organe tjera në kontestet pasurore-juridike.
6. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror mund të autorizojë edhe personin e punësuar në organin e administratës shtetërore me provimin e dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punët juridike, që të përfaqësojë në gjykata dhe organe të tjera në kontestet pasurore-juridike.

#### **Neni 11 Përjashtimi**

Rregullat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve, përshtatshmërisht zbatohen edhe për përjashtimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe për avokatët shtetëror.

#### **Neni 12 Shpenzimet e përfaqësimit**

Shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit të Përgjithshëm shtetëror dhe avokatëve shtetërorë i bart avokatura shtetërore.

#### **Neni 13 Struktura e Avokaturës Shtetërore**

1. Avokaturën shtetërore e udhëheq Avokati i përgjithshëm shtetëror.
2. Avokatura Shtetërore ka numër të caktuar të avokatëve shtetëror.
3. Numri i avokatëve shtetërorë dhe struktura organizative e Avokaturës shtetërore rregullohet me akt nënligjor, që e miraton Ministria e Drejtësisë.

#### **Neni 14 Papajtueshmëria**

Avokati Shtetëror nuk mund të ushtrojë funksione të tjera publike, ose private të cilat janë në kundërshtim me funksionet e tij të përcaktuara me këtë ligj.

#### **Neni 15 Konflikti i Interesit**

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij publike, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, si dhe cilido avokat tjetër shtetëror, nuk mund të përfaqësojë autoritetet publike nëse ka interes personal direkt ose indirekt në rastin që gjykohet.

**KREU III**  
**EMËRIMI DHE PUSHIMI NGA FUNKSIONI**

**Neni 16**

**Emërimi i Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror**

1. Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror me propozimin e Ministrit të Drejtësisë e emëron Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror emërohen me konkurs publik sipas procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, një gjyqtar i Gjykatës së Apelit apo i Gjykatës Themelore, një prokuror i shtetit, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe një profesor i Fakultetit të drejtësisë.
4. Avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore emërohen me konkurs të hapur publik nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Për emërimin e avokatëve shtetëror përshtatshmërisht zbatohen dispozitat për emërimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.

**Neni 17**

**Kohëzgjatja e funksionit**

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror emërohet për periudhën tre (3) vjeçare dhe mund të emërohet përsëri.
2. Avokatët shtetëror emërohen pa kufizim të kohëzgjatjes së funksionit.

**Neni 18**

**Kushtet për emërim**

1. Për Avokat të Përgjithshëm Shtetëror dhe për avokat shtetëror mund të emërohet çdo person i cili i plotëson këto kushte të përgjithshme:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të jetë jurist i diplomuar;
  - 1.3. të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;
  - 1.4. të jetë person me kualitete të larta morale, të ketë përvojën e nevojshme dhe aftësi profesionale në fushën e drejtësisë;
  - 1.5. të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
  - 1.6. të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo nga ndonjë funksion tjetër publik i Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes së detyrës, apo paafësisë për të kryer detyrën.
2. Personi mund të emërohet për Avokat të Përgjithshëm Shtetëror, nëse përveç kushteve të parapara me këtë ligj plotëson edhe kushtet e veçanta, të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në punët juridike në ndonjë institucion të judikaturës, avokaturës apo në institucione tjera.
3. Personi mund të emërohet për avokat shtetëror nëse përveç kushteve të parapara me këtë Ligj plotëson edhe kushtin e veçantë, të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në punët juridike në ndonjë institucion të judikaturës, avokaturës apo në institucione tjera.

**Neni 19**  
**Marrja e detyrës**

Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, përkatësisht Avokati shtetëror i emëruar, ia fillon detyrës menjëherë pas emërimit, e më së voni në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është emëruar.

**Neni 20**  
**Pushimi i funksionit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror**

1. Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror i pushon funksioni:

- 1.1. me kërkesën e tij;
- 1.2. kur i mbush gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet për shkuarje të detyrueshme në pension;
- 1.3. kur skadon afati për të cilin është emëruar;
- 1.4. në rastin e shkarkimit të tij si rezultat i procedurës disiplinore;
- 1.5. nëse në bazë të dokumentacionit medicinal të institucionit shëndetësor vërtetohet se përgjithmonë e ka humbur aftësinë punuese për ushtrimin e detyrës;
- 1.6. nëse është dënuar për vepër penale, me burg efektiv, në kohëzgjatje së paku gjashtë (6) muaj.

**Neni 21**  
**Pushimi i funksionit të avokatit shtetëror**

1. Funksioni i avokatit shtetëror pushon:

- 1.1. me kërkesën e tij;
- 1.2. kur mbush moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare për shkuarje të detyrueshme në pension;
- 1.3. në rastin e shkarkimit të tij/saj si rezultat i procedurës disiplinore;
- 1.4. nëse në bazë të dokumentacionit medicinal të institucionit shëndetësor vërtetohet se përherë e ka humbur aftësinë për ushtrimin e detyrës;
- 1.5. nëse është dënuar për vepër penale, me burg efektiv, në kohëzgjatje së paku gjashtë (6) muaj.

**Neni 22**  
**Suspendimi**

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, apo avokati shtetëror i cili gjendet në paraburgim suspendohet (suspendimi i detyrueshëm). Suspendimi zgjatë derisa personi gjendet në paraburgim.

2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe Avokati Shtetëror suspendohen (suspendimi diskrecional) nëse:

- 2.1. kundër tij ka filluar hetimi në procedurën penale;
- 2.2. kundër tij prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë për vepër penale;
- 2.3. kundër tij ka filluar procedura e shkarkimit;

2.4. kundër tij ka filluar procedura disiplinore, ndërsa organi disiplinor vërteton se, përgjegjësia disiplinore nuk mund të përcaktohet në mënyrë të drejtë nëse Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, apo avokati shtetëror përkohësisht nuk suspendohen gjatë procedurës;

2.5. kryerja e detyrave zyrtare në mënyrë të konsiderueshme është rënduar për shkak të gjendjes së tij mentale, emocionale dhe fizike.

#### **Neni 23**

#### **Përgjegjësia e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatëve shtetëror**

Dispozitat për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, lidhur me menaxhimin dhe përgjegjësinë e funksioneve për emërimet të larta në mënyrë të përshtatshme vlejné edhe për Avokatin e Përgjithshëm Shtetërorë dhe për avokatët shtetëror.

### **KREU IV**

### **TË PUNËSUARIT NË AVOKATURËN SHETËRORE**

#### **Neni 24**

#### **Personeli civil në Avokaturën Shtetërore**

1. Avokatura Shtetërore ka numër të caktuar të nëpunësve civil për kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike.

2. Avokatura Shtetërore mund të punësojë numër të caktuar të zyrtarëve profesional, të cilët iu ndihmojnë bartësve të funksioneve në kryerjen e punëve juridike.

3. Numri i nëpunësve civil në Avokaturën Shtetërore përcaktohet me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Avokaturës Shtetërore, të cilin e përgatitë Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, e miraton Ministri i Drejtësisë.

4. Dispozitat për shërbimin civil në organet e administratës shtetërore, përshtatshëmrisht zbatohen edhe për nëpunësit civil në Avokaturën Shtetërore, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

#### **Neni 25**

#### **Aftësimi profesional**

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokatët shtetëror dhe nëpunësit civil në Avokaturën Shtetërore, kanë të drejtë dhe detyrim në aftësim dhe arsimim profesional të përhershëm.

2. Për nevoja të aftësimin profesional sigurohen mjetet e nevojshme të cilat janë të parapara në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të ndara për Avokaturën Shtetërore.

#### **Neni 26**

#### **Vlerësimi i punës profesionale**

1. Në fund të çdo viti kalendarik, avokatët Shtetëror i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të punës profesionale, e cila kryhet nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, i cili merr parasysh rezultatet e arritura gjatë procedurave gjyqësore dhe përfaqësimeve të kryera gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Kriteret për vlerësim, rregullat dhe procedurat përcaktohen me Rregullore të brendshme të Punës së Avokaturës Shtetërore, të cilën e nxjerr Ministri i Drejtësisë.

3. Vlerësimi me të cilin konstatohet paaftësi profesionale përbën shkak për inicim të shkarkimit të një avokati shtetëror.

## **KREU V PAGAT**

### **Neni 27 Pagat e Avokatëve Shtetëror**

1. Niveli i pagës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror, caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e dispozitave për pagat e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues.
2. Niveli i pagës së personelit tjetër të Avokaturës Shtetërore përcaktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil.

## **KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 28 Marrja e lëndëve**

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, do ti marr lëndët nga kompetenca e vet, nga Divizioni për Përfaqësim në Ministrinë e Drejtësisë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotësimit të vendeve të punës, e cila siguron funksionimin e Avokaturës Shtetërore.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror duhet me shkrim ta informoj Ministrin e Drejtësisë për marrjen e lëndëve nga paragrafi 1. i këtij neni në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e kryerjes së pranimit-dorëzimit.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe Udhëheqësi i Divizionit për Përfaqësim pranë Ministrisë së Drejtësisë nga paragrafi 1. i këtij neni përpilojnë regjistrin e lëndëve të marra, evidencën dhe arkivin e lëndëve.
4. Ditën e marrjes së lëndëve Divizioni për Përfaqësim pranë Ministrisë së Drejtësisë do të pushojë t'i kryej detyrat e përfaqësimit të autoriteteve publike.

### **Neni 29 Vazhdimi i punës së personelit civil**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Divizionin për Përfaqësim në Ministrinë e Drejtësisë vazhdojnë të punojnë në Avokaturën Shtetërore në pajtim me dispozita e këtij ligji.
2. Të gjithë zyrtarët ligjorë në divizionin për përfaqësime që kanë ushtruar detyrat e përfaqësimit të institucioneve publike dhe që i plotësojnë kushtet sipas këtij ligji për t'u emëruar avokat shtetëror do ta kenë statusin e avokatit shtetëror.

### **Neni 30 Emërimi i Avokatit të përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror**

Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji emërohet Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, ndërsa brenda tre (3) muajve pas emërimit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror emërohen avokatët shtetëror.

### **Neni 31 Aktet nënligjore**

Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxirren aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.

**Neni 32**  
**Shfuqizimi i legjislacionit të aplikueshëm**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet legjislacioni i aplikueshëm për avokaturën publike.

**Neni 33**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-157**  
**12 mars 2013**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-008-2013, datë 26.03.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.**